



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 263/3 Prot.

Tiranë, më 04.02.2022

VENDIM  
Nr. 8, datë 04.02.2022

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË STUDIMEVE TË SPECIALIZIMEVE  
AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69, pika 3; neni 70, pika 4; neni 77, pika 1 dhe 3; neni 78, pika 1 dhe 3; neni 132; Kodit të Procedurave Administrative; Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", Standardeve të cilësisë për programet e ciklit të tretë "Specializime afatgjata", miratuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të cilësisë së arsimit të lartë" të Këshillit të Ministrave, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2021-2022 e në vijim, bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me standardet e cilësisë për programet e ciklit të tretë "Specializime afatgjata".
2. Rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me VSA nr. 88, datë 16.11.2016, e ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare, si dhe Ministrive përgjegjëse për arsimin dhe shëndetësinë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
ARBEN GJATA**

